



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

REFERENCË:	045/2021
Data/e	14/04/2021
PËR/ZA/TO:	Znj. Arta RAMA-HAJRIZI, Kryetare e Gjykatës Kushtetuese
CC:	Z. Milot VOKSHI, Sekretar i Përgjithshëm në Gjykatën Kushtetuese Z. Fitim KRASNIQI, Sekretar i Përgjithshëm në ZKM
NGA/OD/FROM:	Albin Kurti, Kryeministër i Republikës së Kosovës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje në kërkesë në rastin nr. KO 61/21

E nderuara znj. Rama-Hajrizi,

Të nderuar gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese,

Bazuar në njoftimin tuaj të datës 30 mars 2021, Qeveria e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Qeveria) i dorëzon Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), përgjigje në kërkesën e parashtruar nga 11 deputetë të Kuvendit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës):

Historiku procedural

1. Më 06.01.2021 Gjykata Kushtetuese ka publikuar aktgjykimin në rastin nr. KO 95/20, përmes të cilit ka obliguar Presidentin e Republikës së Kosovës që të

shpallë zgjedhjet, të cilat duhej të mbaheshin brenda 40 ditëve nga dita e shpalljes së tyre.

2. Në të njëjtën ditë, u.d. Presidentja Dr. Vjosa Osmani, përmes Dekretit nr. 03/2021 ka shpërndarë Kuvendin e Republikës së Kosovës, ndërsa përmes vendimit nr. 02/2021 ka shpallur zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.
3. Më 14.02.2021, janë mbajtur zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në të cilat Lëvizja VETËVENDOSJE! ka fituar shumicën e nevojshme për të formuar Qeverinë.
4. Më 21.03.2021, Kryetari i Lëvizjes VETËVENDOSJE! z. Albin Kurti i dërgoi një letër kryetarit të Listës Serbe z. Goran Rakic dhe e njoftoi që në përputhje me nenin 95 të Kushtetutës, nga grupi parlamentar i tyre - si përfaqësues të pakicës serbe në Kosovë - në kuadër të përbërjes së re të Qeverisë do të emërojë një ministër dhe tre zëvendësministra sipas propozimit të grupit parlamentar të Listës Serbe.
5. Më 22.03.2021, u mbajt seanca konstitutive e Kuvendit të Kosovës. Në të njëjtën ditë, u.d. Presidenti z. Glauk Konjufca propozoi z. Albin Kurtin si kandidat për Kryeministër të Republikës së Kosovës. Po në të njëjtën ditë, z. Albin Kurti zhvilloi takime konsultative me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, përfshirë edhe përfaqësuesit e grupit parlamentar të Listës Serbe.
6. Në të njëjtën ditë, Kuvendi i Republikës së Kosovës me 67 vota për, zgjodhi Qeverinë e Republikës së Kosovës të përbërë nga Kryeministri, tre (3) zëvendëskryeministra dhe pesëmbëdhjetë (15) ministra, nga të cilët tre (3) sipas propozimit të përfaqësuesve të pakicave të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës.
7. Më 29.03.2021, Parashtruesit e kërkesës dorëzuan në Gjykatën Kushtetuese një kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Qeverisë së Kosovës.nr. 08/V-005 të datës 22.03.2021.

Pranueshmëria

8. Kërkesa është dorëzuar nga 11 deputetë të Kuvendit të Kosovës dhe bazohet në nenin 113.5 të Kushtetutës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) në

lidhje me nenin 42 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejme Gjykata).

9. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 113.5 parasheh të drejtën e dhjetë (10) apo më shumë deputetëve të Kuvendit të Kosovës që brenda 8 ditëve të kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë një ligji apo vendimi të Kuvendit, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga procedura.
10. Neni 42 paragrafi 2 i Ligjit obligon parashtruesit e kërkesës që të informojnë Gjykatën në lidhje me dispozitat kushtetuese dhe ligjore që kanë të bëjnë me aktin e kontestuar. Ndërsa paragrafi 3 i të njëjtit nen përcakton detyrimin e tyre që të ofrojnë provat mbi të cilat mbështetet kontesti.
11. Qeveria konsideron se parashtruesit janë palë e autorizuar sipas nenit 113.5 të Kushtetutës, kanë ushtruar të drejtën e tyre brenda afatit kushtetues, kanë informuar Gjykatën në lidhje me dispozitat kushtetuese të cilat kanë relevancë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar, mirëpo kanë dështuar të ofrojnë prova në lidhje me pretendimet e tyre.
12. Duke marrë parasysh rëndësinë e praktikës gjyqësore kushtetuese në materializimin e Kushtetutës dhe ofrimin e një sigurie juridike, Qeveria e konsideron të nevojshme që pavarësisht faktit se kërkesa nuk mbështetet në prova dhe nuk arsyeton pretendimin e parashtruesve për pakushtetutshmërinë e vendimit të kontestuar (qartazi e pabazuar në baza kushtetuese), me qëllim që procedura e zgjedhjes dhe emërimit të përfaqësuesve të pakicave në kuadër të Qeverisë së Kosovës të konsiderohet e gjykuar nga Gjykata Kushtetuese, Qeveria e konsideron të nevojshme dhe në interes të stabilitetit kushtetues që Gjykata të shpallë të pranueshme kërkesën dhe të vendos në merita të rastit. Sepse një çështje konsiderohet „*res judicata*“ vetëm kur ajo gjykohet përmes një aktgjykimi dhe jo nëse për shkak të mungesës së arsytimit shpallet e papranueshme proceduralisht.

Meritat e rastit

13. Parashtruesit e kërkesës kërkojnë që vendimi i kontestuar të shpallet në kundërshtim me nenin 96 paragrafët 3 dhe 5 të Kushtetutës së Kosovës. Ata po ashtu kërkojnë nga Gjykata që të obligojë Kryeministrin të kryej riorganizimin e Qeverisë dhe të emërojë një ministër më shumë nga pakica serbe.

14. Më saktë, parashtruesit e kërkesës kontestojnë shprehimisht vetëm zgjedhjen e z. Elbert Krasniqit në pozitën e Ministrit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, duke pretenduar se kandidati për kryeministër nuk i ka konsultuar në lidhje me zgjedhjen e tij.
15. Në lidhje me pretendimet dhe kërkesën përfundimtare të parashtruesve të kërkesës, Qeveria konsideron se duhet referuar dispozitave kushtetuese të cilat përcaktojnë procedurën për zgjedhjen e Qeverisë dhe atyre që garantojnë të drejtat e pakicave për përfaqësim në kuadër të saj, me qëllim që të vlerësohet nëse vendimi i kontestuar është nxjerrë sipas procedurës së paraparë me Kushtetutë dhe nëse i njëjti është për nga përmbajtja në përputhje me Kushtetutën.

Neni 95 [Zgjedhja e Qeverisë]

- 1. Pas zgjedhjeve, Presidenti i Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë.*
- 2. Kandidati për Kryeministër, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas emërimit, paraqet përbërjen e Qeverisë para Kuvendit të Kosovës dhe kërkon miratimin nga ana e Kuvendit.*
- 3. Qeveria konsiderohet e zgjedhur nëse merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës.*
- 4. Nëse përbërja e propozuar e Qeverisë nuk merr shumicën e votave të nevojshme, Presidenti i Republikës së Kosovës, brenda dhjetë (10) ditësh emëron kandidatin tjetër sipas së njëjtës procedurë. Nëse as herën e dytë nuk zgjidhet Qeveria, atëherë Presidenti i Kosovës i shpall zgjedhjet, të cilat duhet të mbahen jo më vonë se dyzet (40) ditë nga dita e shpalljes së tyre.*
- 5. Nëse Kryeministri jep dorëheqjen ose për arsye të tjera, posti i tij/saj mbetet i lirë, Qeveria bie, dhe Presidenti i Republikës së Kosovës, në konsultim me partitë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend, mandaton kandidatin e ri, për të formuar Qeverinë.*
- 6. Anëtarët e Qeverisë pas zgjedhjes, japin betimin para Kuvendit. Teksti i betimit rregullohet me ligj.*

Neni 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve]

(...)

3. Në Qeveri do të jenë së paku një (1) Ministër nga komuniteti Serb dhe një (1) Ministër nga ndonjë komunitet tjetër joshumicë në Kosovë. Nëse janë më shumë se dymbëdhjetë ministra, Qeveria do të ketë edhe një ministër të tretë, i cili përfaqëson një nga komunitetet joshumicë në Kosovë.

(...)

5. Zgjedhja e këtyre ministrave dhe zëvendësministrave do të vendoset pas konsultimit me partitë, me koalicionet ose grupet që përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë. Nëse caktohen kandidatë jashtë deputetëve të Kuvendit të Kosovës, për këta ministra e zëvendësministra kërkohet miratimi formal i shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët u përkasin partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin në fjalë.

(...)

16. Sipas paragrafit 3 të nenit 95 të Kushtetutës, Qeveria konsiderohet e zgjedhur nëse ajo siguron shumicën absolute (50%+1) të votave nga 120 deputetët e Kuvendit të Kosovës.
17. Duke marrë parasysh se Qeveria është zgjedhur me votën e 67 deputetëve të Kuvendit, ajo është zgjedhur me shumicën absolute ashtu si parashihet me Kushtetutë.
18. Duke u mbështetur në parimin *non ultra petita* (jo përtej kërkesës), të cilin konsiderojmë se duke u bazuar në praktikën e saj do ta zbatojë edhe vet Gjykata (shih Aktgjykimin në rastin nr. KO 95/20 të datës 06.01.2021), Qeveria do të kufizohet në pretendimin e parashtruesve nëse zgjedhja e z. Krasniqit ka qenë në kundërshtim me Kushtetutën, ngase parashtruesit e kërkesës pretendojnë se zgjedhja e tij në pozitën e ministrit nuk është bërë pas konsultimit me ta.
19. Qeveria thekson se parashtruesit kanë keqinterpretuar paragrafët 3 dhe 5 të nenit 96 të Kushtetutës, sepse kandidati për kryeministër i ka përmbushur detyrimet kushtetuese të parapara me këtë kushtetutë.
20. Në bazë të paragrafit 3 të nenit 96 të Kushtetutës, do të jetë një (1) ministër nga komuniteti serb dhe një (1) ministër nga komunitetet tjera pakicë në Kosovë.

Nëse janë më shumë se dymbëdhjetë ministra, Qeveria do të ketë edhe një ministër të tretë, i cili përfaqëson një nga komunitetet joshumicë në Kosovë.

21. Kushtetuta pra nuk përcakton se ministri i tretë i cili përfaqëson komunitetet pakicë domosdoshmërisht duhet të jetë përfaqësues i komunitetit serb. Kushtetuta në këtë rast është e qartë dhe përmban një formulim preciz, i cili nuk lë hapësirë për dykuptimësi.
22. Sipas legjislacionit në fuqi, nocioni “komunitet joshumicë” nuk i referohet vetëm komunitetit serb, por edhe komuniteteve tjera joshumicë që jetojnë në Republikën e Kosovës. Mbi këtë parim ndahen edhe ulëset e garantuara për komunitetet joshumicë, sipas nenit 64(2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Për më tepër, një ndarje e qartë lidhur me komunitetet joshumicë në Republikën e Kosovës ofrohet edhe nga dispozitat e Ligjit Nr.03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Republikën e Kosovës. Neni 1(4) i ligjit përcakton se *“komunitetet përkufizohen si grupe kombëtare, etnike, kulturore, gjuhësore apo fetare tradicionalisht të pranishme në Republikën e Kosovës të cilat nuk janë shumicë. Këto grupe janë komuniteti serb, turk, boshnjak, rom, ashkali, egjiptian, goran dhe komunitete të tjera”*.
23. Edhe në raste tjera të përzgjedhjes së anëtarëve të komuniteteve joshumicë në Republikën e Kosovës, siç është rasti i përzgjedhjes në borde të ndërmarrjeve publike apo në pozita nëpër institucione të pavarura, ekzistojnë rregulla të qarta e gjithpërfshirëse për të gjitha komunitetet që jetojnë në Republikën e Kosovës, jo vetëm për komunitetin serb.
24. Rast konkret është përzgjedhja e zëvendësve të Avokatit të Popullit. Sipas nenit 10(5) të Ligjit Nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit, gjatë procedurës së zgjedhjes së kandidatëve për zëvendësit e Avokatit të Popullit, duhet të sigurohet përfaqësimi etnik dhe gjinor, ku të paktën njëri nga zëvendësit e Avokatit të Popullit duhet të jetë pjesëtar i njërit nga komunitetet dhe gjinisë tjetër që ndryshon nga ajo e Avokatit të Popullit. Siç vërehet, Ligji nuk përcakton se nga cili komunitet joshumicë duhet të zgjidhet një zëvendës i Avokatit të Popullit, por kjo nuk nënkupton, siç e dëshmon edhe praktika, që kjo pozitë me automatizëm i takon një anëtarë që vie nga komuniteti serb.
25. I njëjti parim vlenë edhe në rastin e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës. Neni 8(2) i Ligjit Nr. 06/L -048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës specifikon se *“Përbërja e Këshillit pasqyron karakterin shumetnik dhe gjinor të Kosovës. Së paku dy (2) anëtarë emërohen nga komunitetet joshqiptare [...]”*. I

njëti parim haset edhe te përzgjedhja e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media, ku neni 10(5) i Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave konstaton se “Së paku dy (2) anëtarë të KPM-së emërohen nga radhët e komuniteteve joshqiptare [...]”.

26. Të gjitha këto raste vërtetojnë se në momentin kur nuk specifikohet se nga i cili komunitet joshumicë duhet të zgjidhet/emërohet një anëtar, ajo nuk nënkupton se me automatizëm këta të zgjedhur/emëruar duhet të jenë nga komuniteti serb. Kjo dëshmohet nga praktika e deritanishme e funksionimit të këtyre Institucioneve të Pavarura, të cilat anëtarët e tyre i zgjedhin pas votimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
27. Parashtruesit e kërkesës tutje konsiderojnë se nuk janë konsultuar në lidhje me zgjedhjen e ministrave që propozohen nga përfaqësuesit e pakicave në Kosovë.
28. Mirëpo, parashtruesit e kërkesës konfirmojnë vet se më datën 21.03.2021 kanë pasur një letërkëmbim me kandidatin për kryeministër, ndërsa me datën 22.03.2021 janë takuar me të, pas mandatimit formal nga u.d. Presidenti. Rrjedhimisht është konsumuar detyrimi kushtetues i konsultimit me ta si përfaqësues të pakicës serbe në Kosovë. Po ashtu, ata konfirmojnë se z. Goran Rakic është zgjedhur ministër sipas propozimit të grupit të tyre parlamentar.
29. Sikur të ishte shpërfillur propozimi i tyre dhe në vend të z. Rakic të ishte zgjedhur një person tjetër në pozitën e ministrit të garantuar për përfaqësuesit e pakicës serbe, atëherë pretendimi i parashtruesit do të kishte bazë. Mirëpo, të njëjtit nuk e kontestojnë zgjedhjen e z. Rakic.
30. Qeveria konsideron se parashtruesit nuk e kanë kuptuar drejtë konceptin e konsultimit si pjesë e procedurës për zgjedhjen e Qeverisë. Madje pretendimi i tyre për çështjen e konsultimit nuk mbështetet as nga pjesët e Komentarit të Kushtetutës (i cili paraqet një tekst jodetyrues për Gjykatën, pra paraqet vetëm një mendim të autorëve) të cilat ata i citojnë në lidhje me pranimin e kandidatit të propozuar.
31. Konsultimi nuk është kategori e cila i jep të drejtën një pakice të caktuar që të diktojë përbërjen dhe ndarjen e ministrive në kuadër të Qeverisë. Mirëpo ai është një proces i cili i jep të drejtën përfaqësuesve të asaj pakice që të njoftojnë kandidatin për Kryeministër se cilët do të jetë përfaqësuesit e asaj pakice në kuadër të përfaqësimit të garantuar me Kushtetutë.
32. Për më tepër, Kushtetuta përcakton pragun minimal të përfaqësimit në Qeveri, që për pakicën serbe përmban (1) ministër dhe dy (2) zëvendësministra. Në

rastin konkret është shtuar edhe një (1) zëvendësministër, në përputhje me nenin 96.4, sepse Qeveria ka më shumë se dymbëdhjetë ministri.

33. Pra Kushtetuta parasheh një (1) zëvendësministër më shumë për komunitetin serb, në rast se janë më shumë se 12 ministri, dhe nuk parasheh një ministër më shumë.
34. Pavarësisht faktit se përfaqësuesit e pakicës serbe kanë formuar një grup të përbashkët parlamentar me përfaqësuesin e pakicës gorane, Kushtetuta i referohet deputetëve që mbajnë vendet e garantuara si përfaqësues të pakicës serbe dhe jo grupeve parlamentare që mund të formohen e në të cilat bëjnë pjesë edhe deputetët e pakicës serbe apo grupe parlamentare të formuara nga përfaqësuesit e pakicave të ndryshme.
35. Qeveria thekson se arsyetimi i parashtruesve se pretendimet e tyre kanë bazë për faktin se Republika e Kosovës paraqet një model të „demokracisë konsociacionale“ nuk është relevant dhe nuk paraqet një arsyetim kushtetues. Modeli i demokracisë së konsensusit (*apo konsociacionale, si është quajtur në fillim nga politologu Arend Lijphart*), është një klasifikim që përdoret në shkencat politike dhe është jorelevant për sferën e të drejtës kushtetuese, por që as nga prizmi i shkencave politike nuk gjen zbatim në rastin e Kosovës, sepse Republika e Kosovës ndër të tjera nuk është shtet federal dhe nuk është shtet i themeluar si konsensus mes disa kombeve që janë pajtuar për të themeluar një shtet shumetnik në të cilin njësitë federale do të konsideroheshin si përfaqësuese të një kombi të caktuar. Në Republikën e Kosovës nuk qeveriset me rotacion dhe Qeveria nuk gëzon mbrojtje nga shkarkimi përmes mocionit të mosbesimit. Prandaj as argumentet jorelevante nga teoria politike nuk mbështesin pretendimet e parashtruesve.
36. Qeveria rithekson se Republika e Kosovës është shtet i shtetasve të vet (neni 2.1 i Kushtetutës) dhe shoqëri shumetnike e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike (neni 3.1. i Kushtetutës). Në kuadër të kësaj demokracie, shumica shqiptare ka garantuar përfaqësimin e pakicave në kuadër të institucioneve të saj dhe përmes dispozitave të mësipërme kushtetuese ka garantuar karakterin unitar të rendit kushtetues dhe territorit të Republikës së Kosovës (neni 1 i Kushtetutës).
37. Prandaj, Qeveria rithekson se përfaqësuesit e pakicës serbe në Kuvendin e Kosovës janë konsultuar dhe propozimi i tyre është marrë parasysh në lidhje me emërimin e ministrit që përfaqëson pakicën serbe në Qeverinë e Kosovës dhe

njëjtë do të merren parasysh edhe propozimet e tyre në lidhje me zëvendësministrat.

38. Qeveria rithekson se pretendimi i parashtruesve të kërkesës së zgjedhja e z. Elbert Krasniqit është në kundërshtim me Kushtetutën, nuk qëndron. z. Elbert Krasniqi është i zgjedhur deputet në legjislaturën e tetë si kandidat i IRDK, pra deputet që përfaqëson një komunitet joshumicë në Kosovë prandaj nuk është shkelur Kushtetuta dhe nuk janë cenuar të drejtat e pakicës serbe për përfaqësim në Qeverinë e Kosovës.
39. Fakti se në legjislaturën e shtatë z. Elbert Krasniqi ka qenë pjesë e grupit parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE! nuk e zhbën faktin se ai ka vazhduar të jetë deputet që ka fituar mandatin si përfaqësues i një komuniteti joshumicë. Por, duhet theksuar se organizimi i grupeve parlamentare në kuadër të legjislaturës së shtatë është jorelevant për procesin e zgjedhjes së Qeverisë dhe ndarjen e mandateve në legjislaturën aktuale. Sepse parashtruesit kontestojnë një vendim të legjislaturës aktuale të Kuvendit dhe jo të asaj paraprake.
40. Duke marrë parasysh se ministrat z. Fitim Damka dhe z. Elbert Krasniqi para zgjedhjes së tyre në pozitën e ministrit kanë qenë deputet të Kuvendit të Kosovës, nuk është kërkuar një miratim formal i shumicës së deputetëve që mbajnë vende të rezervuara.
41. Përfundimisht Qeveria konsideron se përfaqësimi i garantuar nga Kushtetuta e Kosovës për përfaqësuesit e pakicës serbe është respektuar me rastin e zgjedhjes së Qeverisë, rrjedhimisht vendimi i kontestuar është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Kërkesa për masë të përkohshme

33. Përveç mungesës së arsyeshmërisë për kërkesën për masë të përkohshme, vendosja e masës së përkohshme do të ishte në kundërshtim të plotë me interesin publik. Përmes masës së përkohshme, Qeveria konsideron që do të shkaktohej dëm i pariparueshëm, në një kohë kur vendit i duhet Qeveri funksionale në sigurimin e vaksinave për mbrojtje nga pandemia COVID-19 dhe në menaxhimin e përgjithshëm të pandemisë. Për më tepër, vendosja e masës së përkohshme do të ndikonte direkt edhe në mundësitë e Qeverisë për të punuar në procesin e rimëkëmbjes ekonomike si dhe do të rrezikonte edhe sigurinë kombëtare. Prandaj, një masë e përkohshme për rastin në fjalë nuk është në interesin publik, si dhe mund të shkaktoj dëm të pariparueshëm.

34. Duke marrë parasysh se parashtruesit e kërkesës nuk kanë paraqitur asnjë argument i cili do të arsyetonte vendosjen e masave të përkohshme, Qeveria propozon që kërkesa për vendosjen e masës së përkohshme të refuzohet.

Kërkesa për seancë dëgjimore

35. Qeveria konsideron se në rastin konkret nuk ka asnjë paqartësi në lidhje me çështjet e ligjit dhe faktit, prandaj kërkesa për mbajtjen e seancës dëgjimore nuk është justifikuar. Rrjedhimisht propozojmë që e njëjta të refuzohet.

Përfundimi dhe kërkesa

Në përputhje me arsyetimin e kësaj parashtrëse, Qeveria e Republikës së Kosovës kërkon nga Gjykata Kushtetuese që të nxjerrë Aktgjykim me të cilin:

- I. SHPALLË kërkesën të pranueshme.
- II. KONSTATON se vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Qeverisë së Kosovës nr. 08/V-005 të datës 22.03.2021 është në përputhje me nenin 96 paragrafët 3, 4 dhe 5 të Kushtetutës.
- III. REFUZON kërkesën për vendosjen e masave të përkohshme.
- IV. REFUZON kërkesën për mbajtjen e seancës dëgjimore.
- V. PUBLIKON këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës

Me respekt,



Albin Kurti

Kryeministër i Republikës së Kosovës